VENDIM
Nr. 43, datë 23.9.2016

PËR LICENCIM SHA UJËSJELLËS
URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit sh.a. Ujësjellës Ura Vajguror me:

Drejtues ligjor: Petref Sula
Drejtues teknik: Jolanda Gjordeni

2. Operatori sh.a Ujësjellës Ura Vajgurore autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Ura Vajgurore.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani